REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/17/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga av. Sh.H, ndaj gjyqtares F. U-I për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 29.04.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga avokat Sh.H ndaj gjyqtares E.U-I, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Avokat Sh.H ka ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares F.U.-I e cila është pranuar nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 04.04.2022. Me datë 15.04.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës të parashtruesit.

Parashtruesi i ankesës avokat Sh.H ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtares F.U-I për shkak të pretendimeve se, gjyqtarja nuk ka caktuar seancë për ndërrimin e masës së sigurisë edhe përkundër shumë kërkesave – parashtresave të tij. Ka theksuar se sipas nenit 309 par.3, masa e sigurimit mbetet në fuqi më së shumti deri në skadimin e afatit prej 30 ditësh pas krijimit të kushteve për ekzekutim të detyrueshëm. Parashtruesi ka shtuar se, gjyqtarja ka pasur sjellje të vrazhdët duke i thënë edhe paditësit edhe avokatit "dilni jashtë e kurrë mos më vini në zyre". Tutje, në ankesë paraqitësi ka theksuar se, gjyqtarja ka inate personale ndaj paditësit dhe avokatit vetëm se ka dorëzuar disa kërkesa që të caktohet seanca për ndërrimin e masës së sigurisë, se në këtë rast duhet të veprohet me urgjencë.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtarja ka deklaruar se, me datë 16.10.2019, paditësi I.D përmes të autorizuarit të tij pranë kësaj Gjykate ka iniciuar padi, kundër të padituve N.P.B me seli në Prishtinë dhe B.G nga Prishtina, për lirim lokalit dhe kompensim dëm, me kërkesë për caktimin e masës së sigurimit.

Tutje, gjyqtarja në deklaratën e saj ka theksuar se, me aktvendimin C.nr.3526/19 të datës 24.07.2020 gjyqtarja S.B-SH ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, i cili është vërtetuar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac.nr.4480/18 të datës 08.01.2019, ndërsa më datë 09.07.2021 në procedurën përmbarimore është zbrazur lokali nga njerëzit dhe sendet. Ka shtuar se, me datë 11.11.2021 av Sh.H ka parashtruar kërkesë që të referohet lënda në procedurë të ndërmjetësimit, me arsyetimin se ekziston vullneti i palëve ndërgjyqëse për zgjidhje e kontestit në procedurë të ndërmjetësimit. Në këtë drejtim është caktuar seanca për referimin e lëndës në ndërmjetësim më datë 21.11.2021, e meqenëse në seancë nuk ka prezantuar i padituri B.G edhe përkundër faktit se ftesën për seancë e ka pranuar, mirëpo mungesën nuk e ka arsyetuar, gjykata me aktvendim ka konsideruar se nuk ekziston pëlqimi për referim të rastit të ndërmjetësim dhe çështja i mbetet gjykatës që ta zgjidhë sipas radhës.

Për më tepër, gjyqtarja në deklaratën e saj ka theksuar se, pretendimet të autorizuarit të paditësit av Sh.H, të konstatuara në parashtresën e datës 04.04.2022, janë të pabazuara, të njëjta janë konstatuara edhe në dy kërkesat përmes të cilave është kërkuar përjashtimi i gjyqtares nga procedimi i kësaj lënde. Kjo për faktin se nuk ka parashtruar ndonjë arsye konkrete apo prova materiale për të vërtetuar këto konstatime. Ka theksuar se, arsyeja pse në këtë lëndë nuk është proceduar për kërkesën kryesore është se është e ngarkuar me lëndë të kësaj natyre që janë shumë më të vjetra krahasuar me këtë lëndë.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit së ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares F.U-I.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet/mosveprimet e gjyqtares F.U-I, lidhur me lëndën për të cilën është ankuar parashtruesi.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruesit se, gjyqtarja është treguar e njëanshme për mos caktimin e seancave për ndërrimin e masës së sigurisë, konkretisht me moszbatimin e nenit 309.3 të LPK-së, Autoriteti kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk qëndrojnë sepse neni të cilin i është referuar parashtruesi zbatohet pas marrjes së aktgjykimit të formës së prerë, pra pas vendosjes së çështjes kryesore, e jo para marrjes së aktgjykimit të formës së prerë.

Gjithashtu, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e ndryshimit të vendimit të marr nga gjykata përkatësisht nga gjyqtarja e rastit, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtarja F.U-I ka qenë e njëanshme në veprimet e saj dhe nuk i ka trajtuar palët në mënyrë të barabartë, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e parashtruesit të ankesës, sepse pretendimet e tilla nuk janë dëshmuar me asnjë provë, dhe për këtë Autoriteti Kompetent vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për më tepër, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se, për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur, qoftë ndaj aktvendimit ndaj të cilit lejohet ankesa qoftë ndaj aktgjykimit por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për moscaktimit të seancës për zgjidhjen e çështjes kryesore, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se, lëndët e rregullta kontestimore në gjykatë procedohen sipas radhës së vjetërsisë në pajtim me Strategjinë dhe planin e gjykatës për kryerjen e lëndëve të vjetra dhe atyre me prioritet ligjor siç janë: Kërkesat për Urdhër Mbrojtje, lëndët për çështje statusore dhe familjare, lëndët për konteste pune, pengim posedimi etj.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/17/22, me datë 29.04.2022

Albina Shabani Rama

_____

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë